



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE SH.P.K

NIPT L71710039A

Nr.1179 Regj
Nr.1592 Prot

Tiranë, më 08.06.2020

URDHËR

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa: Tirane
Per dijeni: P.F Vladimir Shehu me NIPT L33318001M
Adresa: Bilisht, ne hyrje te qytetit, prane Tirana Bank, Bilisht.
Per dijeni: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Adresa: Rr. “Myslym Keta”, Tiranë

Unë, Resul Alushani, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr. Regj. 187 date 01.04.2019 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1179, Datë 27.02.2020 kërkesën e kreditorit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj debitorit P.F Vladimir Shehu me NIPT L33318001M, në lidhje me titullin ekzekutiv “Proçesverbal Inspektimi dhe Vendimi Perfundimtar Nr. 0008601, date 11.12.2017”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 1326 Prot, Datë 14.05.2020, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr. Regj. 187 date 01.04.2019 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori P.F Vladimir Shehu me NIPT L33318001M, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit P.F Vladimir Shehu me NIPT L33318001M, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, **me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,**

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore **P.F Vladimir Shehu me NIPT L33318001M, me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.**
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

**ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE
PËRMBARUESI GJYQËSOR
RESUL ALUSHANI**

